Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor
http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1457/2026
Data: 30.09.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 32 të Rregullores Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar dhe Udhëzuesit Nr.2-2531 për Zëvendësimin dhe Pagesën e Mësimdhënësve me Gjendje të Rëndë Shëndetësore shqyrtoj kërkesën Nr.340/26 të datës 29.09.2026 të parashtruar nga Drejtori i SHFMU-së "Ndre Mjeda" në Rakosh znj.Egzon Haxhijaj i cili ka kërkuar që mësimdhënësi i gjeografisë Haxhi Llullaku sipas raporteve mjekësore të lirohet me pagës nga procesi mësimor, dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet: kërkesa Nr.340/26 e datës 29.09.2026 e parashtruar nga SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh për lirim të mësimdhënësit të gjeografisë z.Haxhi Llullaku nga marrëdhënia e punës me pagesë për shkak të gjendjes së rend shëndetësorë.
2. Mësimdhënësi i liruar nga detyra do të mere pagë 100% të pagës bazë duke përjashtuar shtesën e kualifikimit.
3. Ky lirim nga marrëdhënia e punës për mësimdhënësin do të zgjasë deri në fund të gjysme vjetorit të parë të vitit shkollor 2026/2027.
4. I njëjti mund të rikthehet në punë edhe para përfundimit të afatit të përcaktuar më piken 3 të dispozitivit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2026 Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog ka pranuar njoftimi Nr.340/26 të ndërmjetësuar nga SHFMU-së "Ndre Mjeda" në Rakosh me të cilin njoftim është kërkuar që mësimdhënësi i gjeografisë Haxhi Llullaku të lirohet me pagës nga procesi mësimor për shkak të gjendjes së rend shëndetësore të konstatuar sipas raporteve mjekësore të lëshuara nga (ISHP).

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës dhe raporteve mjekësore të bashkangjitura konsideron se kërkesa e parashtruar nga shkolla për lirim nga procesi mësimor më pagesë për shkak të gjendjes së rende shëndetësorë të mësimdhënësin është në harmoni të plotë me dispozitat e Udhëzuesit Nr.2-2531 për Zëvendësimin dhe Pagesën e Mësimdhënësve me Gjendje të Rëndë Shëndetësore.

Për këtë me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjykatën për Çështje Administrative në Prishtinë brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Haxhi Llullaku,
-Drejtoria Komunale të Arsimit
-Drejtorisë së SHFMU-së "Ndre Mjeda" në Rakosh
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1455/2026
Data: 29.09.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025, të datës 31.07.2025 Komisioni për shqyrtim të kërkesave Zyra e Kryetarit shqyrtoi kërkesën 01Nr.400-35933 të datës 28.09.2026 të parashtruar nga Ajmane Metaj nga fshati Shushicë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për punimin e shenjës kundër kancerit te gjirit, dhe me shkresë të datës 28.09.2026 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.400-35933 e datës 28.09.2026 e parashtruar nga Ajmane Metaj për përkrahje financiare për punimin e shenjës kundër kancerit te gjirit, dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **shtatëqind pesëdhjetë euro (750.00)€** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga nën kodi i ekonomik i barazisë gjinore nga programi buxhetor i Drejtorisë së Administrate.

2. Mjetet financiare të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Ajmane Metaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorisë së Administrate.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Ajmane Metaj
- Drejtorisë së Administrate dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1454/2026
Datë: 29.09.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008)*, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe në pajtim me nenin 19, paragrafi 19.16, të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë Komunale të Arsimit, me 05 Nr.566/26, të datës 29.09.2026, për emërimin e zyrtarit nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Naim Sadriu, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim, si zyrtar përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike për aktivitetin ekonomik dhe shërbimin e konsulencës individuale për pozitat: Zyrtar për Arsim Profesional dhe 2 (dy) Logopedë.

2. Zyrtari i emëruar nga pika 1 e këtij Vendimi obligohet që specifikimet teknike t'i hartojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe ta plotësojë dhe dorëzojë Deklaratën nën Betim, përmes formularit standard të miratuar nga KRPP-ja, në pajtim me nenin 19, paragrafin 19.16, të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, ndërsa për zbatimin e tij obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit dhe z. Naim Sadriu.

4. Ky vendim është përfundimtar.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *z. Naim Sadriu;*
- *Zyrës së Prokurimit;*
- *Drejtorisë së Arsimit; dhe*
- *Arkivit të zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E ISTOGUT · OPŠTINA ISTOK · REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 1452 /2026
Data: 28.09.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, në Nenin 4 paragrafi 1 nen paragrafi 1.8 dhe neni 6 paragrafi 1. të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025,te datës 31.07.2025 dhe bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur në mes të komunës dhe OJQ Komisioni për shqyrtimin e kërkesave Zyra e Kryetarit shqyrtoj kërkesën 01 Nr.400-35350 të datës 21.09.2026 të parashtruar nga Enisa Gubernić përfaqësuese e shoqatës se gruas "Vas Kutak" Lubovë Istog, për përkrahje financiare për aktivitetet për ditën e Boshnjakëve dhe me procesverbal të datës 28.09.2026, të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.400-35350 e datës 21.09.2026 e parashtruar nga Enisa Gubernić përfaqësuese e shoqatës se gruas "Vas Kutak" Lubovë Istog, për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve për komunitetin Boshnjak dhe me propozim të Komisioni i ndahen mjete financiare në shumë prej **treqind e pesëdhjetë euro 350.00€** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga nën programi buxhetor Drejtoria për Administratë Komunale.

2. Mjetet e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Shoqates se Gruas **Vas Kutak** në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Enisa Gubernić ,
- Drejtoria për Administratë Komunale,
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

U.D. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1450/2026
Datë: 28.09.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, paragrafi 1, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008)*, neneve 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016)*, nenit 68, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, duke u bazuar në kërkesën nr. 06-553-35535, të datës 23.09.2026, të paraqitur nga z. Uka Kerellaj, nga fshati Shalinovicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për mbulimin e shpenzimeve të transportit të tij, për trajtim me kimioterapi në Klinikën e Onkologjisë pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë, si dhe në bazë të dokumentacionit mjekësor të paraqitur dhe Procesverbalit të Komisionit nr. 341/2026, të datës 25.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa nr. 06-553-35535, e datës 25.09.2026, e paraqitur nga z. Uka Kerellaj, nga fshati Shalinovicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për mbulimin e shpenzimeve të transportit të tij, për trajtim me kimioterapi në Klinikën e Onkologjisë pranë QSKUK-së në Prishtinë, në relacionin Istog-Prishtinë dhe anasjelltas.
Bazuar në dokumentacionin mjekësor të paraqitur dhe Procesverbalin e Komisionit nr.341/2026, të datës 25.09.2026, sipas të cilit, Uka Kerellaj do t'i nënshtrohet **8 (tetë fraksione) fraksioneve të trajtimit**, përcaktohet sasia totale prej **120 (njëqind e njëzetë)** litrash karburant, përkatësisht nga **15 (pesëmbëdhjetë) litra** për secilën seancë, në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025.

2. Obligohet Zyrtari i Transportit që ta pajisë z. Uka Kerrellaj me vërtetim për furnizim me karburant për automjetin që do të shfrytëzohet për realizimin e transportit të tij për trajtim shëndetësor në Klinikën e Onkologjisë pranë QKUK-së në Prishtinë, në sasinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
Furnizimi me karburant do të realizohet në përputhje me procedurat në fuqi dhe në kuadër të programit buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjëse janë Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në procedurë administrative. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *z. Uka Kerellaj;*
- *Drejtorisë për Shëndetësi;*
- *Zyrtarit të Transportit; dhe*
- *Arkivi i Zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1449/2026
Data: 28.09.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe ne fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 25.09.2026 të parashtruar nga Prokurimi, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: LOT 1 - Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Muzhevinë-Lluga . LOT 2- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Shushicë. LOT 3- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Cerrcë. LOT 4- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Istog. LOT 5- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Kamenicë Lagjja Metaj dhe Lipaj me numër të prokurimi 633-26-7437-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-026-048-521 , nxjerr:

V E N D I M

1.CAKTOHET: Menaxher i kontratës Kompania Mbikëqyrëse PMN, për projektin; "LOT 1 - Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Muzhevinë-Lluga . LOT 2- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Shushicë. LOT 3- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Cerrcë. LOT 4- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Istog. LOT 5- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Kamenicë Lagjja Metaj dhe Lipaj me numër të prokurimi 633-26-7437-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-026-048-521 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Abedin Kabashi** Drejtor për Shërbime Publike, për kontratën lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesve të tenderit.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekura e marrin: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Prokurimit,
- Kompania Mbikëqyrëse PMN ,
- Abedin Kabashi Drejtor për Shërbime Publike, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

KOMUNA ISTOG * OPŠTINA ISTOK * REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1448 /2026 http://kk.rks-gov.net/istog/
Data: 28.09.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2. dhe neni 6 paragrafi 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për shqyrtim të kërkesave Bujqësi dhe Zhvillim Rural, shqyrtoi kërkesën 09Nr.320-35275 të datës 21.09.2026 të parashtruar nga Hazir Muzlijaj nga Orrobërda,Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për ndërtimin e stallës së bagëtive dhe me procesverbal Nr.09/101/2026 të datës 25.09.2026 nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 09Nr.320-35275 të datës 21.09.2026 e parashtruar nga Hazir Muzlijaj për përkrahje financiare për ndërtimin e stallës së bagëtive dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **gjashtëqind euro (600.00)€,** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Mjetet financiare të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Hazir Muzlijaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Hazir Muzlijaj,
- Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

U.D. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1447/2026
Datë: 28.09.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, paragrafi 1, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008)*, neneve 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016)*, nenit 68, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, duke u bazuar në kërkesën nr. 06-553-35527, të datës 23.09.2026, të paraqitur nga z. Fadil Ukaj, nga fshati Banjicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për mbulimin e shpenzimeve të transportit të bashkëshortes së tij, znj. Xhevahire Ukaj, për trajtim me radioterapi në Klinikën e Onkologjisë pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë, si dhe në bazë të dokumentacionit mjekësor të paraqitur dhe Procesverbalit të Komisionit nr. 334/2026, të datës 24.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa nr. 06-553-35527, e datës 23.09.2026, e paraqitur nga z. Fadil Ukaj, nga fshati Banjicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me lëndë djegëse (karburant) për mbulimin e shpenzimeve të transportit të bashkëshortes së tij, znj. Xhevahire Ukaj, për trajtim me radioterapi në Klinikën e Onkologjisë pranë QKUK-së në Prishtinë, në relacionin Istog-Prishtinë dhe anasjelltas.
Bazuar në dokumentacionin mjekësor të paraqitur dhe Procesverbalin e Komisionit nr.334/2026, të datës 24.09.2026, sipas të cilit znj. Xhevahire Ukaj do t'i nënshtrohet **25 (njëzet e pesë) fraksioneve të trajtimit**, përcaktohet sasia totale prej **375 (treqind e shtatëdhjetë e pesë)** litrash karburant, përkatësisht nga **15 (pesëmbëdhjetë) litra** për secilën seancë, në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025.

2. Obligohet Zyrtari i Transportit që ta pajisë z. Fadil Ukaj me vërtetim për furnizim me karburant për automjetin që do të shfrytëzohet për realizimin e transportit të znj. Xhevahire Ukaj për trajtim shëndetësor në Klinikën e Onkologjisë pranë QKUK-së në Prishtinë, në sasinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
Furnizimi me karburant do të realizohet në përputhje me procedurat në fuqi dhe në kuadër të programit buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjëse janë Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në procedurë administrative. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

➢ *Vendimi u dërgohet:*
- *z. Fadil Ukaj;*
- *Drejtorisë për Shëndetësi;*
- *Zyrtarit të Transportit; dhe*
- *Arkivi i Zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01.Nr.1446 /2026
Datë: 25.09.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqevrisje Lokale publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28/2008) :

P r o p o z o n

Kuvendit të Komunës ,që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) në lidhje më nenin 8 paragrafi 1 pika 1.2, neni 19 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,nenit 5 pika paragrafi 1.3, nenit 13, nenit 20,si dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,Vendimin Paraprak 00.Nr.185/2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së interesit, Vendimin 00.Nr.33/2025 të datës 31.01.2025 mbi themelimin e Komisionit Vlerësues si dhe njoftimit të datës 19.05.2025 nga Komisioni Vlerësues për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e ofertave, në mbledhjen e planifikuar për tu mbajtur më datë 28.09.2026 të miratojë këtë:

VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS PALUAJTSHNE TË KOMUNËS,
Të parcelës Nr.541-0 ZK Veriq (Përmes shprehjes së Interesit)

1.I propozohet Kuvendit Komunal shfuqizimi i vendimit 01.Nr.110/2025 i datës 30.05.2026,përmës të cilit parashihej dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht parcelën Nr.541-0 ZK Veriq me sipërfaqe prej (123813)m² pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut evidentuar sipas certifikatës pronësore, ofertuesit "Infrasol Technology Shpk" në periudhë prej 30 (tridhjetë) viteve.

2.Shfuqizimi këtij vendimi vjen si rezultat pasi, qe pas përfundimit të procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (përmes shprehjes së interesit) ofertuesi "Infrasol Technology ShPK" edhe pse është njoftuar së është shpallur përfitues i njëjti nuk është paraqitur edhe përkundër së është njoftuar zyrtarisht për kohen dhe datën e lidhjes së marrëveshjes (Kontratës).Përfaqësuesi i autorizuar nuk ka prezantuar brenda afatit të caktuar në njoftim me çka konsiderohet se ka hequr dorë vullnetarisht nga lidhja e kontratës.

3.Pas miratimit të këtij propozim vendimi për shfuqizim nga ana e Kuvendit të Komunës së Istogut dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal –MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në nenin me nenin 81 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ,nenin 17 të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web faqen e Komunës.

4.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen ,Zyra e Kryetarit ,Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

Zyrtar ligjor për çështje Pronësore
Blerim Ukaj
BUkaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1445/2026
Data: 25.09.2026

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 25.09.2026 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të aktivitetit për projektin: "LOT 1 - Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Muzhevinë-Lluga . LOT 2- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Shushicë. LOT 3- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Cerrcë. LOT 4- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Istog. LOT 5- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Kamenicë Lagjja Metaj dhe Lipaj." nxjerr:

V E N D I M

1.EMËROHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin; "LOT 1 - Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Muzhevinë-Lluga . LOT 2- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Shushicë. LOT 3- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Cerrcë. LOT 4- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Istog. LOT 5- Ndërtimi i Ndriçimit Publik në Kamenicë Lagjja Metaj dhe Lipaj me numër të prokurimi 633-26-7437-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-026-048-521 dhe në komision caktohen.

1.1. **Naser Nimanaj,** Kryesues i Komisionit,
1.2 **Blerim Bujupi,** anëtar;
1.3. **Alban Llapi,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e aktivitetit për projektin, si ne piken 1 te këtij vendimi sipas pikës një të këtij vendimi, me qellim të konstatimit të aktivitetit vlerësues si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtaret e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtaret e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t`iu ofroj qasje në oferta qe kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbimeve Publike.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1444/2026
Data: 25.09.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

0Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 13 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave për përkrahje financiare Kulturë Rini dhe Sport, shqyrtoi kërkesën 12Nr-553-35593 të datës 23.09.2026 të parashtruar nga **OJQ "Vullkani i Istogut"**, për përkrahje financiare për kompensim te derivateve për transport, për 3 vetura për të marr pjesë në festivalin në Petnjicë – Mal të Zi me procesverbal 12Nr.73/2026 të datës 25.09.2026 nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 12Nr-553-35593 e datës 23.09.2026 e parashtruar nga OJQ "Vullkani i Istogut" për përkrahje me karburant për pjesëmarrje në festival, përkrahet me 90 litra karburant për veturat: 03-692-HF,Pollo, 03-464-JI,Audi Q5, 03-875-HT, Audi Q5.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që OJQ "Vullkani i Istogut" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- OJQ "Vullkani i Istogut",
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

U.D. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1443/2026
Data: 25.09.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe ne fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 24.09.2026 të parashtruar nga Prokurimi, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: "Renovimi i Shtëpisë së Pleqve në Gurrakoc", nxjerr:

V E N D I M

1.CAKTOHET: Menaxher i kontratës Kompania Mbikëqyrëse PMN, për: "Renovimi i Shtëpisë së Pleqve në Gurrakoc", me numër të prokurimi 633-26-7449-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-026-047-521, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Merita Bytyçi** Drejtoresh për Mirëqenie Sociale, për kontratën lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesve të tenderit.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekura e marrin: Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Prokurimit,
- Kompania Mbikëqyrëse PMN ,
- Drejtorisë për Mirëqenien Sociale, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1442/2026
Data: 25.09.2026

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e datës 24.09.2026 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të aktivitetit për projektin: "Renovimi i Shtëpisë së Pleqve në Gurrakoc " për nevoja të institucioneve Komunale: nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: "Renovimi i Shtëpisë së Pleqve në Gurrakoc", me numër të prokurimi 633-26-7449-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-026-047-521 dhe në komision caktohen.

1.1. Antigona Shatri Bjraktari , Kryesuese e Komisionit;
1.2 Drin Sadikaj, anëtar;
1.3. Berat Gjoci, anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e aktivitetit për projektin, "Renovimi i Shtëpisë së Pleqve në Gurrakoc," sipas pikës një të këtij vendimi, me qellim të konstatimit të aktivitetit vlerësues si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtaret e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtaret e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit t`iu ofroj qasje në oferta qe kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1441/2026
Data: 25.09.2026

Duke vendosur sipas njoftimit Nr.158/26 të datës 24.09.2026 të ndërmjetësuar nga drejtori i SHFMU-së "Ismail Qemali " në Saradran për konfirmimin e pushimit të lehonisë për psikologen znj.Rajmonda Nurçaj, Kryetari i Komunës bazuar në nenin 49. pika 1. e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 13 Rregullores (QRK) NR. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik merr këtë:

V E N D I M

I. znj.Rajmonda Nurçaj e sistemuar në vendin e punës, psikologe në SHFMU "Ismail Qemali" në Saradran i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve, pushimi fillon me 21.09.2026 e deri me 21.09.2027.

II. Sipas pikës 3 të nenit 49, gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë paguhen nga punëdhënësi 70% nga paga bazë duke filluar nga 21.09.2026 e deri me 20.03.2027.

III. Sipas pikës 4 të nenit 49, tre muajt vijues të pushimit të lehonisë paguhen nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në nivel të Kosovës duke filluar nga data 21.03.2027 e deri me 20.06.2027.

IV. Sipas pikës 5 të nenit 49, lehona ka të drejtë të zgjasë pushimin e lehonisë edhe për tre muaj por pa pagesë.

V. Sipas pikës 6 të nenit 49, nëse lehona nuk dëshiron të shfrytëzoj të drejtën sipas pikës 4 dhe 5 është e obliguar që 15 ditë para skadimit të pushimit sipas nenit 3 të lajmëroj punëdhënësin për fillim të punës.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria Komunale e Arsimit, SHFMU-së "Ismail Qemali" Saradran dhe Psikologes.

Vendimi i dërgohet:

-Mësimdhënëses Rajmonda Nurçaj;
-Drejtorisë Komunale të Arsimit;
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
-SHFMU-së "Ismail Qemali" Saradran.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOG - OPŠTINA ISTOK

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1434/2026
Datë: 25.09.2026

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008)*, nenit 69, paragrafi 1, pikave 3 dhe 4, të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/10, si dhe në pajtim me nenin 19, paragrafin 19.16, të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, **pas shqyrtimit të kërkesës** me nr. prot. 12Nr.71/2026, të datës 23.09.2026, të paraqitur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike për aktivitetin e prokurimit „Dekorimi i Qytetit", nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet z. Hekuran Rugova, Arkitekt në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mjedis të Komunës së Istogut, si person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike për aktivitetin e prokurimit me objekt „Dekorimi i Qytetit", në bashkëpunim me Njësinë kërkuese - Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Personi i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet që, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, të hartojë specifikimet teknike për aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe, së bashku me specifikimet teknike, të plotësojë dhe të dorëzojë **Deklaratën nën Betim**, në formularin standard të miratuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), në pajtim me nenin 19, paragrafin 19.16, të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet z. Hekuran Rugova, ndërsa Zyra e Prokurimit obligohet për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme procedurale në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe është përfundimtar.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *z. Hekuran Rugova;*
- *Zyrës së Prokurimit;*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport; dhe*
- *Arkivit të zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir HERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01.Nr.1433 /2026
Datë: 25.09.2026

Kryetari i Komunës, ne harmoni me nenin 13, dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 3,nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L- 081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019), nenin 26 dhe 48 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, shqyrtoj kërkesën e datës 21.09.2026 parashtruar nga av.Florije Curri - Kryeziu adresa Rr. "Dëshmoret e Kombit" Hyrja 68 kati I nr.5 Prishtinë për qasje në dokumente zyrtare i propozon Kryetarit të nxjerr :

V E N D I M
Për qasje në dokumente publike

1. **MIRATOHET- pjesërisht** kërkesa e datës 18.03.2026 të parashtruar av.Florije Curri Kryeziu adresa Rr. "Dëshmoret e Kombit" Hyrja 68 kati I nr.5 Prishtinë për qasje në dokumente zyrtare për të autorizuarit z.Fadil (Ibish) Curraj dhe z.Skender (Ibish) Curraj.

1.1Lejohet qasja në dokumente publike vetëm për pjesën qe disponon Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

2.Vendimi hyn në fuqi ditën nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: znj.Jeta Balaj Imeraj - Zyrtarë për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, po ashtu e njëjta obligohet të dhënat si në pikën 1 të këtij Vendimi, t`i ja dërgoj parashtrueses se kërkesës av.Florije Curri –Kryeziu.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.av.Florije Curri Kryeziu e autorizuar në emër të z.Fadil (Ibish) Cuuraj dhe z.Skender (Ibish) Curraj në mbështetje të Ligjit për Nr.06/L-081 për qasje në Dokumente Publike ka paraqitur kërkesë për qasje ne dokumentet dhe informacionet publike qe posedon, administrohen ose kontrollohen nga institucioni jonë. Pas shqyrtimit të kërkesës ne bazë të dokumenteve që posedon Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ju njoftojmë.
Objekti banesor në të cilin ndodhet edhe njësia banesore e cila është objekt i kërkesës sipas certifikatës pronësore evidentohet me nr.P-70806020-0178-4-40-0 Zona Kadastrale Istog, në fletën poseduese me Nr.4300/2026 e cila sipas certifikatës pronësore figuron "Bashkëpronësi në Ndërtesë në Pjesët e Përbashkëta" ndërsa njësia banesore për të cilën juve ju nevojitet informacioni sipas shënimeve kadastrale evidentohet me Nr.1783-4-40-1-2-0 shfrytëzues z.Ibish Curraj në bazë kontratës Nr.72 e datës 13.05.1980.
Për realizimin e kërkesës për të autorizuarit tuaj ju lutem drejtohuni të Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) Zyra Regjionale në Pejë si trashëgimtar ligjor i Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) ës, pasi Komuna e Istogut zyrtarisht ka mbyllur afatin për paraqitjen e kërkesave për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore bazuar në legjislacionin në fuqi.
Duke ju falënderuar për bashkëpunim për çdo informacion mos hezitoni të na kontaktoni.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në **Agjencinë për Informim dhe Privatësi** në afat prej 15 ditësh pas ditës pas pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
Znj.av.Florie Curri – Kryeziu adresa Rr. "Dëshmoret e Kombit" Hyrja 68 kati I nr.5 Prishtinë.
znj.Jeta Balaj Imeraj Zyrtare për Informim Publik.
Arkivit të Zyrës së Kryetarit.

Zyrtar ligjor për çështje Pronësore
Blerim Ukaj

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1432/2026
Datë: 25.09.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neneve 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 68, paragrafëve 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01/62-10, të miratuar më 30.11.2010, nenit 4, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1, nenit 6, paragrafit 1, si dhe nenit 10 të Rregullores Nr. 146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve, të miratuar më 31.07.2025, pas shqyrtimit të kërkesës me nr. 01-553-34745, të datës 16.09.2026, të paraqitur nga z. Afrim Metaj, nga fshati Cerrcë, për mbështetje financiare për ndërtimin e stallës, si dhe bazuar në propozimin e Komisionit të Zyrës së Kryetarit për shqyrtimin e kërkesave për përkrahje financiare, të evidentuar në Procesverbalin e datës 22.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa me nr. 01-553-34745, e datës 16.09.2026, e paraqitur nga z. Afrim Metaj, nga fshati Cerrcë, për mbështetje financiare për ndërtimin e stallës.

2. Për realizimin e qëllimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, ndahen mjete financiare në shumën prej 750.00 € (shtatëqind e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere", përkatësisht nga programi buxhetor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për mbulimin e shpenzimeve për ndërtimin e stallës.

3. Mjetet financiare të përcaktuara në pikën 2 të këtij Vendimi transferohen në xhirollogarinë bankare të përfituesit, z. Afrim Metaj, në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike.

4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike.

5. Ky Vendim është përfundimtar.

KËSHILLË JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në procedurë administrative. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

➢ ***Vendimi u dërgohet:***
- *z. Afrim Metaj;*
- *Drejtorisë së Shërbimeve Publike; dhe*
- *Arkivit të Zyrës së Kryetarit.*

Zyrtari i Lartë Ligjor
Arlind BALAJ

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1431/2026
Data: 24.09.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për shqyrtim të kërkesave Zyra e Kryetarit, shqyrtoi kërkesën 01Nr.553-3516 të datës 18.09.2026 të parashtruar nga Gjevat Ajdinaj nga Shushica Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për blerjen e terapisë dhe me procesverbal të datës 22.09.2026 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.553-3516 të datës 18.09.2026 të parashtruar nga Gjevat Ajdinaj për përkrahje financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej dyqind e pesëdhjetë euro (250.00€), nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.

2. Mjetet financiare të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Gjevat Ajdinaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyrën e Kryetarit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Gjevat Ajdinaj,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

U.D. i Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim Metaj

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.1428/2026
Data: 24.09.2026

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010 dhe në nenit 4 paragrafi 1, të Rregullores 001Nr.135/2022 për Ndarjen e Bursave për Student të miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 26.09.2022, nxjerr:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR BURSA

1. Ndahen mjete buxhetore për bursa të studentëve për 71 bursistë përfitues të bartur nga viti paraprak, në shumë prej pesëmbëdhjetë mijë e dyqind euro (**50.200.00€**) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale të Arsimit.

2. Mjetet e miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogaritë e secilit përfitues-Bursist, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive sipas listës së bashkangjitur me këtë vendim.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:
-Drejtorisë Komunale të Arsimit,
-Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
-Arkivi i zyrës së Kryetarit

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality of Istog - Opština Istok

KRYETARI / MAYOR / PRESEDNIK

01 Nr. 1423/2026
Datë: 23.09.2026

